



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA MBROJTJES DHE EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIM
Nr. 3 datë 14.06.2024

Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.71 dt.28.09.2023 “Mbi miratimin e objektit “Urë Pasarelë me hapësire drite HD 80 ml” në fshatin Mnelë e vogël

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, Udhezimin Nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave per vitin 2016, VKM nr.216 dt.13.04.2023”Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”

Përsa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të ndryshuar Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.71 dt.28.09.2023 të konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.644/1 dt.16.10.2023 , i propozon Këshillit Bashkiak që me shumice votash :

1. Të miratojë ndryshimet e preventivit në objektin “ Urës pasarelë HD 80 ml në fshatin Mnelë e vogël ” të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës,si rezultat i zbatimit të VKM nr.216 dt.13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si më poshtë vijon:

Ishte

Vlera e preventivit të miratuar në VKB Nr.71 dt.28.09.2023 . **2.491.106.³²** leke (Dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtë (pike tridhjetë e dy) lekë , e cila ishte çelur në degën e thesarit me kod produkti 91707AG sipas shkresës së AKMC nr.86/6 dt.27.03.2023 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile për vitin 2023.

Behet

Vlera e preventivit të azhornuar sipas VKM nr.216, dt.13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e

punimeve në ndërtim behet **2.847.585** lekë (dymilion e tetëqind e katërdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) e cila është çelur në degën e thesarit me kod produkti 91707 AG sipas shkresës së AKMC nr.446/2 dt.20.02.2024 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024”

2. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “sipas shkresës së AKMC Nr.446/6 dt.20.02.2024 “Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” per vitin 2024”.

Konfirmoi bazen ligjore

Jushin Shitani

Jsh

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

Valjeta Nikaj

KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI

Aleksandra GJONI



Vau Dejës, me 14.06.2024

Relacion

Objekti: "Ura Pasarelë HD(hapësirë drite) =80 ml në fshatin Mnelë e vogël Lagjia Rreth

Vendodhja: Mnelë e vogël, Njësia Administrative Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës

Grupi i punës verifikoi gjendjen në të cilën ndodhet ura pasarelë HD=80 ml në fshatin Mnelë e vogël (lagjia Rreth) gjatë vitit 2023 në zbatim të urdhrin të ngritur nga titullari i Bashkisë,Ura pasarelë HD 80 ml ndodhet në fshatin Mnelë e vogël të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës , në zonën kadastrale 2708 .

Gjatë inspektimit në terren u kryen matjet e urës pasarelë , nga të cilat rezultoi se ura është 80 ml e gjatë. Ura Pasarelë është e ndërtuar me bazament betoni, ku paraqet dëmtime strukturore si në bazamentin e betonit ku duhen bërë përforcime dhe në shpatulla si dhe zevëndësim të dërrasave të dëmtuara.

Në vlerësimin e dëmëve të objektit,që janë bërë gjatë vitit 2023 janë marrë parasysh çmimet e referencës nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe përzgjedhja e zërave të punës janë bërë në mënyrë të tillë, që ura të rikthehet në gjendje optimale përdorimi (funksionimi). Por me daljen e VKM Nr.216 dt.13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim doli si domosdoshmëri ndryshimi i preventivit të bërë vitin e kaluar në të cilin kanë ndryshuar të gjitha zërat e punimeve si më poshtë vijon

Punimet ndërtimore që duhet të kryhen në këtë urë janë si më poshtë:

Gërmim shkambi i copëtuar me ekskavator 1.0 m3 ishte	15.786 leke
Struktura monolite betoni C 16/20	1.683.342 leke
F.V.hekur betoni periodik Ç -5, $\varnothing \geq 12$ m	123.770 leke
Shtresë me dërrasa 8 cm ishatebehet	501.227 leke
Bojë vaji sipërfaqe druri	48.863 leke
Shuma	2.847.585 leke(me TVSH)

Për Bashkisë Vau-Dejës në programin "Emergjencia Civile" për vitin 2024 në dëgën e thesarit është depozituar shuma prej **2.847.585 lekë** për kodin **91707AG** –Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njërëzve

(sipas shkresës tonë nr.1247/1 dt.23.02.2024) në përgjigje shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.446/2 dt.20.02.2024 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024" që do të përdoret bazuar në Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave si dhe në VKM Nr.216 dt.13.04.2023 " Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.

Punoi :Ing.Gjovalin Paci

